REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS-MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE-MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE
DALJE
Njësia org. 01 Data/Datum/Date 04/09/26
Nr. Prot./Br./No. 4870 Nr. i faq./Br.str/No.pg. 2
Prishtinë / Priština / Pristina

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/*
*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01-4870
Datë: 04/09/2026

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G.Z. e Republikës së Kosovës/Nr. 34/18 Nëntor 2022, Prishtinë) nenit 11 të Ligjit nr. 04/L – 138 Për Arsim dhe Aftësim Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7/26 Mars 2013), nënparagrafit 1.11, paragrafit 1 të nenit 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK)- nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nxjerr:

# VENDIM

## Për zbatim në Arsimin Dual të kurrikulës për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit" në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)

1. Të zbatohet kurrikula për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit": në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional:

   1.1. Kurrikula për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit" i takon nivelit 3 dhe 4 të Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës;

   1.2. Kurrikula për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit" i takon shkallës 5 dhe 6 të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës;

   1.3. Kurrikula për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit" zbatohet në nivelin I dhe II të Arsimit dhe Aftësimit Profesional;

1.4. Kurrikula për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit" zbatohet në klasat 10, 11 dhe 12 të arsimit profesional.

2. Kurrikula për profilin „Teknik i Informatikës së Biznesit" fillon të zbatohet në IAAP nga viti shkollor 2026/2027.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara, kërkesës së DAAP në MASH me Nr.4-1619 të datës 27.08.2026 për zbatim në Arsimin Dual të kurrikulës „Teknik i Informatikës së Biznesit" në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi i dërgohet:**

1. AAAPARr;
2. DKA-ve;
3. IAAP-ve;
4. Kabinetit të Ministrit/MASHTI;
5. Zyrës së SP/MASHTI;
6. Departamentit të AAP-së;
7. Arkivit/MASHTI

**Hajrulla Çeku**

**Ministër në detyrë i MASH**